

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KUVENDI KOMUNAL- GJILAN**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **651-24-11889-5-2-1**

Sa i përket tenderit për **Ndërtimi I rrugeve në fshatrat Lipovicë, Myqibabë dhe Depcë**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	Eco Holding Group SH.P.K.
NUI	811915430
Adresa	Rr.Ferizajit, pn Gjilan
Vendi	Gjilan
Kodi postar	60000
Numri Telefonit	049380941
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	Bashkim Haziri
Adresa elektronike	ecoholding.g@gmail.com
Data e parashtrimit të ankesës	25.05.2026

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-it
Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Ndërtimi I rrugeve në fshatrat Lipovicë, Myqibabë dhe Depcë

Numri i prokurimit 651-24-11889-5-2-1

Data e njoftimit për kontratë: 12.11.2024

Hapja e ofertave: 03.12.2024

Njoftimi mbi vendimin dt.30.04.2026

Kërkesa për rishqyrtim e dt. 05.05.2026

Vendimi për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim e dt.18.05.2026

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

Procesverbali i hapjes së tenderit data: 03.12.2024 ora 14:00

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

Jo

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

Kerkese per rishqyrtim eshte bere me daten: 05.05.2026

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmblylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e

Njoftimit për Dhënie e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së

Neni 6 i LPP-së

Neni 7 i LPP-së

Neni 59 i LPP-së

Neni 60 i LPP-së

Neni 62 i LPP-së

Neni 69 i LPP-së

Neni 40 i Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik

Neni 43 i Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Njoftimi mbi vendimin është publikuar me dt.30.04.2026, ku aktiviteti i është anuluar me arsyetimin si më poshtë:

Neni 62
Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit

1. Autoriteti kontraktues duhet të përfundojë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës për njërin nga arsyet :

1.1. një shkelje e ligjit aktual ka ndodhu apo do të ndodh në procedurën e prokurimit , e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amandamenti ligjor të kushteve të prokurimiti , duke përfshirë edhe rastet ku një dispozitë e ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit

Arsyetim:

AK – Kuvendi Komunal Gjilan bënë anulimin e kësaj procedure të prokurimit , pasi që nga Njësia Kërkuese është konfirmuar se nuk mundemi të vazhdohet me procedurën e prokurimit sepse nuk janë të përfshira të gjitha rrugët në pozicione dhe kërkesat e banoreve

Andaj Autoritet Kontraktues –Kuvendi Komunal Gjilan , merr vendim që ta anuloj këtë aktiviteti të prokurimit .

Fillimisht, po e sqarojmë se aktiviteti i prokurimit është publikuar me dt. 12.11.2024, hapja e ofertave është bërë me dt.03.12.2024, ndërsa me dt.24.12.2024 na janë kërkuar dokumentet e përshtatshmërisë, të cilat i kemi dorëzuar në përputhje me kërkesën e dosjes së tenderit. Siç edhe dihet kjo fazë përbën hapin e fundit para shpalljes së fituesit dhe tregon qartë se AK-ja ka përfunduar vlerësimin dhe na ka konsideruar si operatori ekonomik të përgjegjshëm me çmimin më të ulët.

Nga momenti i dorëzimit të këtyre dokumenteve deri më 30.04.2026 nuk është pranuar asnjë vendim, ndërkohë që nga ana jonë është kërkuar vazhdimisht zgjatja e validitetit të ofertës dhe sigurimit të tenderit gjë të cilën e kemi bërë. Pra sipas veprimeve të AK-së tregojnë qartë se në këtë rast është dashur të vazhdohet me procedurat e dhënies së kontratës dhe jo me anulim pas një periudhe kaq të gjatë, duke na mbajtur në pasiguri të plotë juridike pa asnjë arsyetim konkret.

Arsyetimi i autoritetit kontraktues për anulimin e aktivitetit të prokurimit, ku e ka cekur se “Nga njësia kërkuese është konfirmuar se nuk mundemi të vazhdohet me procedurën e prokurimit sepse nuk janë përfshirë të gjitha rrugët në pozicionet dhe kërkesat e banorëve”, është i paqëndrueshëm, jo profesional dhe shumë i vonuar. Nëse një mangësi e tillë do të ekzistonte, ajo duhej të ishte evidentuar para publikimit të aktivitetit, e jo pasi procedura ka arritur në fazën përfundimtare. Fakti që kjo çështje ngrihet pas një viti e gjysmë tregon se nuk kemi të bëjmë me një problem real që e bën të pamundur vazhdimin e procedurës, por me një arsyetim krejtësisht jo profesional dhe tendencioz me qëllim që ne si kompani të mos rekomandohemi për kontratë.

Gjithashtu sqarojmë se arsyetimi i AK-së ku ceket se është pritur një konfirmim nga njësia

kërkuese nuk qëndron, sepse një konfirmim i tillë duhet të ekzistojë para publikimit të tenderit. Në momentin që aktiviteti i prokurimit publikohet dhe vazhdon deri në fazën e kërimit të dokumenteve për shpalljen e fituesit, atëherë nënkuptohet se nevoja, specifikimet dhe përfshirja e të gjitha pozicioneve të paramasës janë verifikuar dhe miratuar paraprakisht. Në këtë rast është jo ligjore që pas përfundimit të vlerësimit të ofertave dhe në prag të dhënies së kontratës të kërkohet një konfirmim i tillë, pasi ky veprim nga ana jonë nuk mund të cilësohet ndryshe përveç se diskriminim i hapur kundrejt kompanisë tonë, për më tepër kur kemi parasysh faktin se një konfirmim i tillë përmendet pas 1 viti e gjysmë.

Po ashtu, arsyetimi tjetër për “kërkesat e banorëve” është i papranueshëm në këtë fazë. Kërkesa të tilla siç e ka cekur AK-ja, **nëse ekzistojnë** duhet të trajtohen para inicimit dhe publikimit të tenderit. Pas publikimit dhe sidomos pasi operatorët ekonomikë kanë ofertuar dhe procedura ka avancuar deri në përzgjedhjen e fituesit, nuk mund dhe nuk duhet të merren parasysh kërkesa të reja apo të ndryshohen elemente thelbësore të projektit.

Për këto arsye, arsyetimi i AK-së për anulimin e aktivitetit të prokurimit është në kundërshtim të plotë me nenin 62 të LPP-së dhe nenin 43 të RRPP-së Nr.001/2022, pasi që një arsyetim i tillë nuk është real dhe i arsyeshëm për anulimin e aktivitetit në këtë fazë, por vetëm një tendencë jo profesionale për të mos vazhduar me dhënien e kontratës

Arsyetimi i AK-së, se një dispozitë e LPP-së kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit është plotësisht i pa qëndrueshëm, sepse asnjë dispozitë e LPP-së nuk përcakton se në këto raste duhet të anulohet një aktivitet i prokurimit, prandaj arsyeja e anulimit është e kundërligjshme. AK-së nuk e ka cekur asnjë dispozitë se ku mbështetet anulimi i aktivitetit dhe këtë normalisht që nuk ka mund ta argumentojë pasi që asnjë dispozitë e legjislacionit të prokurimit nuk e lejon që në këto raste mund të anulohet një tender, por e njëjta vetëm është referuar tek neni 62 i LPP-së.

Si përfundim, anulimi i aktivitetit të prokurimit nga ana e AK-së është i pabazuar dhe në kundërshtim me procesin e procedurës, e cila ka arritur deri në fazën përfundimtare para shpalljes së fituesit. Arsyetimet e paraqitura, si konfirmimi nga njëria kërkuese dhe pretendimet për kërkesa të banorëve, nuk përbëjnë bazë reale për anulim në këtë fazë, pasi këto çështje duhet trajtuar para publikimit të tenderit. Në asnjë moment nuk është dëshmuar ekzistimi i ndonjë shkeljeje që e bën të pamundur vazhdimin e procedurës. Po ashtu, nuk është përmbushur asnjë nga kushtet ligjore për anulim sipas dispozitave përkatëse. Për rrjedhojë, ky vendim paraqet një arsyetim të paqëndrueshëm dhe një

përpjekje për të mos vazhduar me dhënien e kontratës.

Ne me dt.18.05.2026 kemi pranuar vendimin për refuzimin e kërkesës tonë për rishqyrtim si të pa lejuar dhe të pa bazuar, mirëpo që asnjë mënyrë nuk është argumentuar e kundërta e pretendimeve tona ankimore.

Autoriteti kontraktues në vendimin e saj për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, ka vepruar në mënyrë të njëjtë sikurse tek njoftimi mbi vendimin e AK-së, pasi që ka përsëritur arsyet e njëjta për anulimin e aktivitetit të prokurimit. Autoriteti kontraktues në asnjë mënyrë nuk ka mundur të dëshmojë të kundërtën e pretendimeve tona ankimore, por vetëm ka përsëritur arsyen e njëjtë. Ne e kemi sqaruar qartë se nëse një mangësi e tillë do të ekzistonte siç pretendon AK-ja, ajo duhej të ishte evidentuar para publikimit të aktivitetit, e jo pasi procedura ka arritur në fazën përfundimtare. Fakti që kjo çështje ngrihet pas një viti e gjysmë tregon se nuk kemi të bëjmë me një problem real që e bën të pamundur vazhdimin e procedurës, por me një arsyetim krejtësisht jo profesional dhe tendencioz me qëllim që ne si kompani të mos rekomandohemi për kontratë. Prandaj arsyetimi i autoritetit kontraktues për ne si OE është i paqëndrueshëm, tendencioz dhe njëkohësisht jo profesional.

Ndërsa sa i përket arsyes tjetër të AK-së ku tani në vendimin mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim e njëjta e ka cekur se ne nuk e kemi vazhduar validitetin e ofertës, sqarojmë se një arsyetim i tillë është i paqëndrueshëm dhe tendencioz kundrejt kompanisë tonë.

Sqarojmë se ne e kemi bërë vazhdimin e validitetit të ofertës dhe sigurimit të tenderit konform kërkesave të vet AK-së dhe brenda afateve të kërkuara. Rrjedhimisht, pretendimi i AK-së se OE nuk ka qenë i interesuar për vazhdimin e procedurës është i pabazuar dhe tendencioz. Për më tepër, AK-ja në këtë fazë vetëm është duke bërë përsëritje të arsyes së anulimit **dhe duke shtuar arsye të reja, të cilat nuk kanë qenë pjesë e arsyetimit fillestar të vendimit për anulim.** Një veprim i tillë nga ana e AK-së tregon qartë tendencën e të njëjtës që me çdo kusht të bëjë anulimin e aktivitetit të prokurimit, sepse tani po shtohen edhe arsye tjera se kinse ne nuk e kemi vazhduar validitetin e ofertës e që një gjë e tillë është e paqëndrueshme.

AK-ja në asnjë mënyrë nuk ka arritur të dëshmojë se është plotësuar ndonjëra nga kushtet ligjore të parapara me nenin 62 të LPP-së dhe nenin 43 të RRPP-së për anulimin e aktivitetit të prokurimit, ndërsa arsyetimet e dhëna janë vetëm tentativa për të

arsyetuar një vendim të kundërligjshëm pas përfundimit të vlerësimit të ofertave dhe në prag të dhënies së kontratës.

Duke u bazuar në të gjitha faktet dhe argumentet e paraqitura më lartë, rezulton qartë se vendimi i AK-së për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim është i pabazuar, i paarsyetuar dhe i pambështetur në dispozitat ligjore të LPP-së dhe RRPP-së.

Mbi këtë bazë ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe neni 60 i LPP-së.

Duke pasur parasysh këtë vlerësim konsiderojmë se kemi trajtim jo të barabartë të kompanisë tonë dhe diskriminim në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së.

Gjithashtu, anulimi i këtij aktiviteti të prokurimit është bërë në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së dhe nenin 43.5 dhe 43.7 të RRPP Nr.001/2022, pasi që nuk janë plotësuar asnjëra prej kushteve të përcaktuara në këto dispozita.

Neni 43.5 i RRPP Nr.001/2022 i ka parashikuar kushtet që duhet të plotësohen për anulim, si më poshtë:

43.5 Procedura e prokurimit pas hapjes së ofertave duhet të anulohet për një nga arsyet e mëposhtme:

a. asnjë tender nuk është paraqitur brenda afatit të specifikuar;

b. asnjëri prej tenderëve të pranuar nuk është i përgjegjshëm;

RREGULLORE Nr.001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK

81

c. numri i OE të përgjegjshëm për kontratë publike kornizë me më shumë se një OE është më pak se 3(tre);

d. nuk ka kërkesa për të marrë pjesë, në procedurat e kufizuara ose konkurruese me negociata, që janë paraqitur brenda afatit të specifikuar;

e. numri i kandidatëve të kualifikuar në procedurën e kufizuar/ konkurruese me negociata

është më pak se 3;

f. nuk ka projekte që janë paraqitur brenda afatit të specifikuar;

g. asnjë nga projektet e pranuar në konkursin e projektimit nuk janë të përgjegjshëm;

h. nëse urdhërohet nga Organi Shqyrtues i Prokurimit;

i. një shkelje e ligjit ka ndodhur ose do të ndodhë dhe nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një ndryshimi;

j. nëse AK gjatë përgatitjes dhe udhëheqjes së procedurës ka përdorur gabimisht opsionin për procedurën përkatëse dhe i cili gabim me verifikim të KRPP-se është i pariparueshëm;

k. nëse është paraqitur një gabim teknik në platformën e prokurimit elektronik nga ndonjë situatë e paparashikuar dhe jashtë kontrollit të AK dhe i cili gabim është i pariparueshëm sipas verifikimit dhe konstatimit nga KRPP.

Asnjëra nga kushtet e lartcekura nuk është plotësuar për të bërë anulimin e aktivitetit të prokurimit në këtë fazë, prandaj arsyetimi i AK-së është i paqëndrueshëm.

Duke u bazuar në të gjitha ato që u përmendën më lartë, rezulton se në këtë mënyrë nuk mund të arrihet qëllimi i LPP-së, siç parashihet në nenin 1 të këtij ligji, e ku shkruan qartë: *Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.*

Duke pasur parasysh të gjitha faktet dhe argumentet që u cekën më lartë, kërkojmë nga OSHP-ja që të merr:

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar ankesa e OE OE “**Eco Holding Group**” SH.P.K.,

ANULOHET, njoftimi mbi vendimin e AK-së (B58) për anulimin e aktivitetit të prokurimit dhe lënda kthehet në **RIVLERËSIM**

DETYROHET Autoriteti Kontraktues që rivlerësimin ta bëjë sipas rrethanave faktike dhe ligjore në pajtueshmëri me kërkesat e dosjes së tenderit dhe kërkesat ligjore të LPP-së dhe RRPP.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Neve si Operator Ekonomik na janë bërë dëme materiale për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës, për kërkesën për rishqyrtim, ankesën , arrijnë vlerën prej 5,000.00 euro.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

***Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.